



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 08.07.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MBROTJEN CIVILE”

- **Hyrje**

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë **08.07.2019**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “Për Mbrotjen Civile”

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Mbrojtjes e përfaqësuar nga Z.Petro Koçi, Zëvendësminister

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave i propozuar nga Ministria e Mjedisit, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 78 dhe Rregullores së Kuvendit, neni 55 pika 1 ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Ky projektligj ka për qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të pronës, të gjësë së gjallë, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe me aktet ndërkombëtare.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Ky projektligj është përafëruar plotësisht me direktivën nr.92/43/EEC, “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër”, të ndryshuar, nr.Celex 01992L0043-20070101, publikuar në “Fletoren zyrtare” nr.206, datë 22.7.1992, si dhe është përafëruar pjesërisht me direktivën 2009/147/EC “Për konservimin e shpendëve të egër”, nr.Celex 32009L0147, publikuar në “Fletoren zyrtare” nr.20, datë 26.1.2010, faqe 7-25..

Plani Kombëtar për Integrimin European 2018-2020

Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjike dhe prioritetet e parashikuara në **Kapitulli 27: Mjedisi** të Planit Kombëtar për Integrimin European (PKIE) 2019-2020.

1. ASPEKTET PROCEDURIALE TË PËRAFRIMIT

- Neni 70 i MSA-së njih rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit European;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European;
- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

2. ASPEKTET MATERIALE TË PËRAFRIMIT

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit European (TFBE): Pjesa e Parë, “Parimet”, Titulli I “Kategoritë dhe Fushat e Kompetencës së Bashkimit European”, **neni 6, shkronja “f” “Mbrojtja Civile”**; Titulli XX “Mjedisi”, **Neni 192** (ish-neni 175 TKE); **Titulli XXIII “Mbrojtja civile”, neni 196; Neni 352** (ish-neni 308 TKE).
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Titulli VIII “Politikat e bashkëpunimit”, **neni 108 “Mjedisi”**.
-

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- **Direktiva e Këshillit 2008/114/KE, datë 8 Dhjetor 2008, “Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike europiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre”.**
- **Direktiva 2007/60/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 23 Tetor 2007 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e rriskut të përmbytjeve”.**
- **Direktiva 2012/18/BE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 4 Korrik 2012 “Mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, që ndryshon dhe më pas shfuqizon direktivën e Këshillit 96/82/KE”.**
- **Direktiva 2002/22/KE e Parlamentit European dhe e Këshillit, datë 7 Mars 2002 “Mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike” e ndryshuar, (Direktiva e Shërbimit Universal).**
- **Vendimi Nr.1313/2013/BE i Parlamentit European dhe i Këshillit, datë 17.12.2013 “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit European”, i ndryshuar”.**

Vendimi zbatues i Komisionit 2014/762/BE datë 16.10.2014, që përcakton rregullat për zbatimin e vendimit nr.1313/2013/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit “Mbi

mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit European” dhe që shfuqizon Vendimet e Komisionit 2004/277/KE, Euroatom dhe 2007/606/KE, Euroatom”, i ndryshuar **Niveli i Përafrimit: I pjesëshëm**

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të *Acquis* të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

- ***Konsultimi publik***

Në mbledhjen e Komisionit për Integrimin European nuk ka patur përfaqësues të shoqërisë civile apo të grupeve të interesit

- ***Efektet financiare të aktit***

Ky projektligj nuk do të ketë efekte shtesë financiare në buxhetin e shtetit, pasi zbatimi i projektligjit shoqërohet me kosto, e cila është brenda tavaneve buxhetore, të miratuara për vitin përkatës,

- ***Diskutimi në komision***

Nga komisioni u vlerësuan bashkëpunimi risitë e këtij projektligji.

- ***Ndryshime të projektaktit (nen për nen)***

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa ndryshime si vijon:

3.1 Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën e **Këshillit** 2008/114/KE, datë 8.12.2008, “Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre”. Numri CELEX 32008L0114, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.345, datë 23.12.2008, fq.75-82;
- **Direktivën 2007/60/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 23 Tetor 2007 “Për vlerësimin dhe menaxhimin e rriskut të përmytjeve”**. Numri CELEX 32007L0060, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.288, datë 6.11.2007, fq. 27-34.
- **Direktivën 2012/18/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 4.7.2012, “Mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, që ndryshon dhe më pas shfuqizon Direktivën e Këshillit 96/82/KE”**. Numri CELEX 32012L0018, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.197, datë 24.7.2012, fq.1-37.
- **Direktivën 2002/22/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7.3.2002 “Mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e**

komunikimeve elektronike” e ndryshuar” (Direktiva e Shërbimit Universal). Numri CELEX 32002L0022, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.108, datë 24.4.2002, fq.51-77;

- *Vendimin Nr. 1313/2013/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 17.12.2013 “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit European”, i ndryshuar”. Numri CELEX 32013D1313, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.347, datë 20.12.2013, fq.924–947.*
- *Vendimin zbatues të Komisionit 2014/762/BE, datë 16.10.2014, që përcakton rregullat për zbatimin e vendimit nr.1313/2013/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit European” dhe që shfuqizon Vendimet e Komisionit 2004/277/KE, Euroatom dhe 2007/606/KE, Euroatom”, i ndryshuar. Numri CELEX 32014D0762, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.320, datë 6.11.2014, fq.1–45.*

3.2 Në nenin 3 të projektligjit, pika 16 që jep përkufizimin e termit “Infrastrukturë kritike me efekt ndërkufitar”, riformulohet si vijon:

“16. “Infrastrukturë kritike me efekt ndërkufitar”, ajo infrastrukturë kritike, **ndërprerja** ose shkatërrimi i së cilës do të kishte impakt të rëndësishëm në një ose disa shtete kufitare me Republikën e Shqipërisë. Rëndësia e impaktit duhet të vlerësohet sipas kriterëve ndërsektoriale. Këtu përfshihen efektet që rezultojnë nga varësitë ndërsektoriale në llojet e tjera të infrastrukturës.”

3. KORRIGJIMI I TABELAVE TË PËRPUTHSHMËRISË QË SHOQËROJNË PROJEKTLIGJIN

Tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë projektligjin duhet të korrigjohen nga institucioni propozues, sepse nuk janë plotësuar sipas kriterëve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për instrumentat e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së (Neni 17, pika 2 dhe 3 të ligjit Nr.15/2015). Nga shqyrtimi dhe krahasimi i tabelave të përputhshmërisë me tekstin e projektligjit është konstatuar se tabelat e e përputhshmërisë kanë gabime dhe pasaktësi të cilat duhet të korrigjohen:

Së pari, tabelat e përputhshmërisë nr.5 dhe 6 dhe 7 që shoqërojnë projektligjin janë totalisht gabim dhe duhen korrigjur:

- **në tabelën nr. 5 është shënuar se projektligji është përafruar me “Vendimin e Këshillit të datës 23.10.2001,** “Krijimi i një mekanizmi të mbrojtjes civile për të lehtësuar bashkëpunimin e përforcuar në ndërhyrjet e asistencës për mbrojtjen civile (2001/792/EC, Euratom)”, **ndërkohë që Vendimi i Këshillit 2001/792/KE, Euratom, datë 23.10.2001 është shfuqizuar me Vendimin e Këshillit 2007/779/KE,** Euroatom, datë 8. 11.2007 dhe **ky i fundit është shfuqizuar me Vendimin Nr. 1313/2013/BE** të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 17.12.2013 “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit European”. **Tabela duhet korrigjuar tërësisht, duke shënuar se projektligji është përafruar me Vendimin Nr. 1313/2013/BE të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 17.12.2013 “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit European”, i ndryshuar”.**

- Në tabelën nr.6 është shënuar se projektligji është përafruar me “Vendimin (BE) 2019/420 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13.3.2019, që amendon vendimin nr.1313/2013/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17.12.2013, “Për mekanizmin e BE-së për mbrojtjen civile””. Por, rezulton se projektligji është përafruar me versionin e konsoliduar të Vendimit Nr.1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17.12.2013 “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian”, i ndryshuar” dhe jo vetëm me Vendimin (BE) 2019/420 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13.3.2019. Tabela duhet korrigjuar tërësisht duke shënuar se projektligji është përafruar me Vendimin Nr. 1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17.12.2013 “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian”, i ndryshuar.
- Në tabelën nr.7 është shënuar se projektligji është përafruar me “Vendimin zbatues të Komisionit (BE) 2018/142, të datës 15.1.2018, për ndryshimin e vendimit zbatues 2014/762/BE, i cili përcakton rregullat për zbatimin e vendimit nr.1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për mekanizmin e bashkimit të mbrojtjes civile”. Por, rezulton se projektligji është përafruar me versionin e konsoliduar të Vendimit zbatues të Komisionit 2014/762/BE, datë 16.10.2014, dhe jo vetëm me Vendimin zbatues të Komisionit (BE) 2018/142, të datës 15.1.2018. Tabela duhet korrigjuar tërësisht duke shënuar se projektligji është përafruar me Vendimin zbatues të Komisionit 2014/762/BE, datë 16.10.2014, që përcakton rregullat për zbatimin e vendimit nr.1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit “Mbi mekanizmin e mbrojtjes civile të Bashkimit Evropian” dhe që shfuqizon Vendimet e Komisionit 2004/277/KE, Euroatom dhe 2007/606/KE, Euroatom”, i ndryshuar”.

Së dyti, nga shqyrtimi dhe krahasimi i numrit dhe i tekstit të neneve të akteve ligjore të BE-së të përafruara nga projektligji i propozuar dhe i numrit dhe tekstit të neneve të projektligjit, të shënuara në tabelat e përputhshmërisë, me numrin dhe tekstin e neneve të projektligjit, rezulton se numri dhe në disa raste teksti i neneve të projektligjit të shënuara në Tabelat e përputhshmërisë nuk korrespondojnë me numrin dhe tekstin e neneve të projektligjit.

Bazuar në nenin 17, pikat 3 dhe 5 të ligjit 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, sugjerojmë që KIE t’i kërkojë institucionit propozues të projektligjit:

- korrigjimin e tabelave të përputhshmërisë, sipas vërejtjeve të lartpërmendura, dhe ridërgimin e tyre në Kuvend,
- ***reflektimin në tabelat finale të përputhshmërisë të ndryshimeve që do të pësojë projektligji gjatë shqyrtimit dhe miratimit të tij në Kuvend***

Përfundim

- Komisioni për Integritetin Evropian:
 - pasi vlerësoi qëllimin e projektligjit, procedurat ligjore sipas detyrimeve kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit;
 - pasi vlerësoi përputhshmerinë e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian si detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, neni 70;
 - pasi propozoi ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e dispozitave dhe
 - pasi konsideroi se projektligji votohet me mazhorancë të thjeshtë,

e votoi aktin ligjor të propozuar nga Këshilli i Ministrave në parim, nen për nen dhe me ndryshime në tërësi dhe me shumicë votash **e miratoi** atë dhe vendosi për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

NËNKRYETARE

SENIDA MESI